**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**
**DEGA VENDORE TIRANË**
**NOTER JULIAN ZHELEGU**

V2023053950681287153

PULLE TARIFE 200 LEKË

**DATE 21/12/2023**
**NR REP 11426**

## VËRTETIM NJËSIE ME ORIGJINALIN

Sot, më datë 21.12.2023, para meje Noterit JULIAN ZHELEGU, Anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Njesia Bashkiake nr. 5, Rr. Pjeter Bogdani, Godina Nr. 13, Hyrja Nr. 2, u paraqit personalisht:

**KËRKUES/IT**:
**Elona Mena**, atësia Islam, amësia Selvije, shtetase Shqiptare, lindur në F Kuqe, Kurbin dhe banues në TIRANË, me adresë Janaq Paço; Nd. 10; H. 2; Njësia Administrative Nr. 7; Njësia Bashkiake Nr. 7; 1023; Tiranë, lindur më 11/02/1997, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 032749553 dhe nr. personal J75211034C,

e cila me kerkoi te vertetoj dokumentin e njejte me origjinalin: Vendim i "TRUEN " Sh.p.k i dates 01.12.2023.

Unë Noteri, pasi i bëra të qartë personit të mësipërm, përgjegjësinë penale në rast paraqitje të dokumenti të rremë; bëra krahasimin e përmbajtjes së dokumentit origjinal me fotokopjen e paraqitur, mbi të cilat më rezulton se nuk janë bërë korrigjime, shtesa, fshirje, a shenja të tjera të dyshimta.

Si rrjedhim, në bazë të nenit 62, shkronja "i", nenit 129 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë"; Vërtetoj se fotokopja e dokumentit të paraqitur nga kërkuesi para meje Noterit, është e njëjtë me dokumentin origjinal.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të kërkuesit të këtij dokumenti, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**NOTER**

JULIAN ZHELEGU

**RESOLUTION BY WRITE-IN-BALLOT**
**OF THE GENERAL MEETING OF THE SHAREHOLDERS OF**
**THE LIMITED LIABILITIES COMPANY**
**TRUEN SH.P.K.**

**Truen SH.P.K.,** is an Albanian Limited Liability Company, established and duly exercising its activity under the Albanian laws, registered with the Albanian National Business Center with its registration number (NUIS) **L21617015E** and with its registered address at: Blvd. *"Dëshmorët e Kombit"*, Twin Tower No. 1, 7th Floor, 1001 Tirana, Albania (hereinafter referred as **"Truen"** or the **"Company"**). The Executive Director of the Company is **Mr. Julien-Gerard Emile Louis ROCHE** (hereinafter referred to as the **"Executive Director"**).

| | |
|---|---|
| **Date:** | 01/12/2023 |
| **Resolution No.:** | 03/2023 |

**AGENDA:**

1. Approval of the amendment to the share purchase agreement dated 01/06/2023 entered between CN'Air SAS, Ylliad SH.P.K., WEnerg SH.A., Truen and Mr. Julien-Gerard Emile Louis ROCHE;

2. Approval of the amendment to the settlement agreement (hereinafter referred to as the **"Transaction Protocol"**) dated 01/06/2023 entered between Compagnie Nationale du Rhône, CN'Air SAS, Ylliad SH.P.K., WEnerg sh.a, Truen and Mr Julien-Gerard Emile Louis ROCHE;

3. Authorization of the Executive Director to sign the amendment to the share purchase agreement, the amendment to the Transaction Protocol and any other documents regarding the amendment, on behalf of the Company;

4. To approve (in principle) the following changes to the share capital: the increase of share capital of the Company to be paid up through conversion of the loans of the shareholder CN'AIR SAS into share capital and subsequently to reduce the share capital to cover the losses incurred until December 31, 2022;

5. Appointment of MAZARS SH.P.K. with business identification no. K32123006W as independent auditor tasked with preparing an assurance report on the amounts of liabilities of Truen towards CN'Air and their conversion into shares by way of increase of the share capital of the Company, as well on the subsequent reduction of share capital by absorbing losses of the Company incurred until December 31, 2022;

6. Miscellaneous.

**NOTICE** to the members of the General Meeting of the Company, constituted as follows:

- **CN'Air SAS**, a simplified joint stock company, incorporated under the laws of France, registered at the Commercial Tribunal of Lyon with its registration No. 450809835 RCS Lyon, on 14/11/2003, with its registered seat at: 2, Rue André Bonin 69004 Lyon, France (hereinafter referred as "**CN'Air**"), owner of 51% of the share capital of the Company, duly represented by its President, the company Compagnie Nationale du Rhône, herein represented by its General Director **Mr. Julien Rene Pierre FRANCAIS**, citizen of France, born on 03/04/1978 in Saint-Die-des-Vosges (88), France, holder of the ID Card No. 200269158936, acting pursuant to the powers granted to him under the bylaws of the company; and

- **Ylliad SH.P.K.**, an Albanian Limited Liability Company, established on 16/04/2009 and registered with the Albanian National Business Center on 17/04/2009, with NUIS **K91617013R**, with its registered address at: Blvd. *"Dëshmorët e Kombit"*, Twin Tower No. 1, 7th Floor, 1001 Tirana, Albania (hereinafter referred as "**Ylliad**"), duly represented by **Mr. Julien-Gerard Emile Louis ROCHE**, Albanian citizen, born on 02/07/1954, holder of the ID with Personal No. F40702134H, in his capacity of the Administrator of Ylliad, owner of 49% of the share capital of the Company.

From: **Mr. Julien-Gerard Emile Louis ROCHE**
Executive Director
Truen SH.P.K.
Blvd. *"Dëshmorët e Kombit"*, Twin Tower No. 1, 7th Floor, 1001 Tirana, Albania

Date: 01/12/2023

In accordance with Article 9.11 of the Articles of Association of Truen ("**AoA**"), the Shareholders may take any action by write-in-ballot without a meeting.

Terms defined in the SPA (as defined below) shall, unless otherwise defined herein, have the same meaning in this resolution.

WHEREAS:

**A.** The capital of the Company, equal to 44,000,000 Albanian Leke, is divided into 220,000 shares, of which 112,200 shares (representing 51% of the Company's share capital) (hereinafter referred to as the "**CN'Air Shares**") are owned by CN'Air SAS and 107,800 shares (representing 49% of the Company's share capital) are owned by Ylliad;

**B.** On 01/06/2023, CN'Air and Ylliad inter alia have entered into the Transaction Protocol in the framework of the transaction between CNR (COMPAGNIE NATIONALE DU RHÔNE a joint-

stock company, incorporated under the laws of the Republic of France, registered with the Trade and Companies Registry of Lyon with number 957520901, with corporate seat at the address 2, rue André Bonin, 69004 Lyon, France), CN'Air, Ylliad, WEnerg, Truen and Mr. Julien-Gerard Emile Louis ROCHE and in a Sale and Purchase Agreement (hereinafter referred to as the "**SPA**") pursuant to which CN'Air will sell to Ylliad all the shares that CN'Air will own in the share capital of Truen at the effective date of transfer of shares under the SPA and Ylliad will purchase those shares from CN'Air;

**C.** Pursuant to Article 3 Conditions Precedents of the SPA, the Parties have to fulfil certain Suspensive Conditions before or on 30/09/2023;

**D.** CN'Air has granted shareholders loan to Truen amounting to 196,000 Euro. In addition, pursuant to Article 3.6 of the SPA, CN'Air has undertaken to pay to the bank Banka Kombëtare Tregtare SH.A. (hereinafter referred to as the "**BKT**"), on behalf of Truen, an amount equal to 2,100,000 Euro, which amount shall constitute a shareholder loan. In order to take into account the changes in the Leke/Euro exchange rate, CN'Air has undertaken to increase the amount to be paid to Truen in order for Truen to repay the BKT loan to 246,729,494.19 Albanian Leke, which amount corresponds to the outstanding amount, including interest, due to the BKT before the instalment of 20 November 2023 (under the loan contract no. 1 rep, no. 1 col, dated 04.01.2013, provided however that the amount to be paid by CN'Air to BKT shall not exceed 2,400,000 Euro. The overall amounts to be owed to CN'Air by Truen, which amount shall not exceed 2,596,000 Euro, shall be referred to as the "**CN'Air Loan**");

**E.** The Parties wish to amend the SPA in order to (i) postpone the deadline for the fulfilment of the Suspensive Conditions on 15/12/2023, (ii) amend certain articles of the SPA and the Transaction Protocol in order to reflect the increase of the shareholder loan to be paid by CN'Air to Truen in order for Truen to repay the BKT loan and (iii) and make other amendments in the SPA and the Transaction Protocol that the Parties have agreed upon;

**F.** In the framework of the transaction envisaged under the SPA, CN'Air intends to convert the CN'Air Loan into shares by way of an increase of the share capital of the Company;

**G.** Truen has recorded losses until the date 31/12/2022 (referred to as the "**Losses**"). The Company's share capital will be reduced to absorb the Losses;

**H.** In order to verify and increase the share capital through conversion of the CN'Air Loan and reduce the share capital by absorbing the Losses, the general meeting intends to appoint a certified independent auditor which shall prepare an assurance report, based on which the general meeting shall rely to approve respectively the increase of the share capital (by converting the CN'Air Loan into shares) and decrease of the share capital (by absorbing the Losses);

**I.** Pursuant to the Articles 9 and 10 of the AoA, the General Meeting is the decision-making body of the Company, which consists of all the shareholders of the Company;

J. Pursuant to the Articles 9 and 10 of the AoA, the General Meeting is duly convened;

K. This resolution is adopted in accordance with the Articles of Association of the Company and fully respects all the mandatory dispositions of the Law No. 9901, dated 14/04/2008 "*On Entrepreneurs and Commercial Companies*", as amended (hereinafter referred to as the "**Company Law**").

**THEREFORE,** the members of the General Meeting of the Company have **RESOLVED**:

I. **TO APPROVE** the amendment to the SPA;

II. **TO APPROVE** the amendment to the Transaction Protocol;

III. **TO AUTHORIZE** the Executive Director, on behalf of the Company, to sign the amendment to the SPA and the amendment to the Transaction Protocol;

IV. **TO AUTHORIZE** the Executive Director of the Company, Mr. Julien-Gerard Emile Louis ROCHE, to sign and deliver, on behalf of the Company, any necessary document regarding the amendments and their execution and in general to do everything necessary to fulfil and make this resolution effective.

V. **TO APPROVE** (in principle) the following changes to the share capital:
(i) to increase the share capital of the Company to be paid up through conversion of the CN'AIR Loan into share capital; and subsequently
(ii) to reduce the share capital to absorb the Losses;

VI. **TO APPOINT** MAZARS SH.P.K. with identification no. K32123006W as independent auditor tasked with preparing an assurance report on the amount of CN'Air Loan and its conversion into shares by way of increase of the share capital of the Company, as well on the subsequent reduction of the share capital by absorbing Losses of the Company.

Please cast your vote by signing below and return a copy of this document by scanned copy to Mrs. Ortenca HOXHA, ortenca.hoxha@wenerg.org, with address at: Blvd. *"Dëshmorët e Kombit"*, Twin Tower no. 1, 7th Floor, 1001 Tirana, Albania, and transmit two signed originals by registered mail.

Thank you for your cooperation.

**Mr. Julien-Gerard Emile Louis ROCHE**

.......................................

Executive Director

TRUEN SH.P.K.

The members of the General Meeting casted the following vote on the above resolutions proposed by Write-in Ballot No. 03/2023, of date 01/12/2023.

**CAST OF VOTE:**

Resolutions approved: ..............................................................

**Shareholder:** **CN'Air SAS**
Represented by: **Julien Rene Pierre FRANCAIS**

Place: 01/12/23 Date: Lyon

Resolutions rejected: ..............................................................

**Shareholder:** **CN'Air SAS**
Represented by: **Julien Rene Pierre FRANCAIS**

Place: .................... Date: ...............

Resolutions approved: ..............................................................

**Shareholder:** **Ylliad SH.P.K.**
Represented by: Julien-Gerard Emile Louis ROCHE

Place: Tirana Date: 1/12/23

Resolutions rejected: ..............................................................

**Shareholder:** **Ylliad SH.P.K.**
Represented by: Julien-Gerard Emile Louis ROCHE

Place: .................... Date: ...............

NOTER TIRANË

**VENDIM ME FLETËVOTIM ME SHKRIM**
**I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË ORTAKËVE**
**TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**
**TRUEN SH.P.K.**

**Truen SH.P.K.**, është një shoqëri shqiptare me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe që ushtron rregullisht aktivitetin sipas ligjeve të Shqipërisë, regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me numër regjistrimi (NUIS) **L21617015E** dhe me adresë të regjistruar : Bulevardi *"Dëshmorët e Kombit"*, Kulla Binjake Nr. 1, Kati i 7, 1001 Tiranë, Shqipëri (këtu e në vijim referuar si "**Truen**" ose "**Shoqëria**"). Drejtori Ekzekutiv i Shoqërisë është **Z. Julien-Gerard Emile Louis ROCHE** (këtu e në vijim referuar si "**Drejtori Ekzekutiv**").

**Data:** 01/12/2023
**Vendimi Nr:** 03/2023

**RENDI I DITËS:**

1. Miratimi i ndryshimit të marrëveshjes së shitblerjes së kuotave të datës 01.06.2023 lidhur ndërmjet CN'Air SAS, Ylliad SH.P.K., WEnerg SH.A., Truen dhe Z. Julien-Gerard Emile Louis ROCHE;

2. Miratimi i ndryshimit të marrëveshjes së zgjidhjes së mosmarrëveshjes (këtu e në vijim referuar si "**Protokolli i Transaksionit**") të datës 01/06/2023, i lidhur ndërmjet Compagnie Nationale du Rhône, CN'Air SAS, Ylliad SH.P.K., WEnerg sh.a, Truen dhe Z. Julien-Gerard Emile Louis ROCHE;

3. Autorizimi i Drejtorit Ekzekutiv për të nënshkruar ndryshimin e marrëveshjes së shitblerjes së aksioneve/kuotave, ndryshimin e Protokollit të Transaksionit dhe çdo dokument tjetër në lidhje me ndryshimin, në emër të Shoqërisë;

4. Miratimi (në parim) i ndryshimeve të mëposhtme në kapitalin e Truen: rritja e kapitalit të Shoqërisë të paguhet nëpërmjet konvertimit të huasë nga CN'AIR SAS në cilësinë e ortakut në kapital dhe më pas të zvogëlohet kapitali për të mbuluar humbjet e kryera deri më 31 dhjetor 2022;

5. Emërimi i MAZARS SH.P.K. me NUIS K32123006W si ekpert i pavarur i ngarkuar me përgatitjen e nje raporti sigurie mbi vlerat e detyrimeve të Truen kundrejt CN'Air dhe konvertimi i tyre në kuota nëpërmjet rritjes së kapitalit të Shoqërisë, si dhe për zvogëlimin e mëvonshëm të kapitalit duke përthithur humbjet e Shoqërisë të ndodhura deri më 31 dhjetor 2022;

6. Të ndryshme.

**NJOFTIM** për anëtarët e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë, e përbërë si më poshtë:

- **CN'Air SAS**, një shoqëri e thjeshtë aksionare, e themeluar sipas ligjeve të Francës, e regjistruar pranë Regjistrit Tregtar të Lyon me numër regjistrimi 450809835 RCS Lyon, më 14/11/2003, me selinë e regjistruar në: 2, Rue André Bonin 69004 Lyon, Francë (këtu e në vijim referuer si "**CN'Air**"), zotërues i 51% të kapitalit të Shoqërisë, e përfaqësuar rregullisht nga Presidenti i saj, shoqëria Compagnie Nationale du Rhône, e përfaqësuar këtu nga Drejtori i Përgjithshëm i saj **Z. Julien Rene Pierre FRANCAIS**, shtetas francez, i lindur më 04.03.1978 në Saint-Die-des-Vosges (88), Francë, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 200269158936, duke vepruar në zbatim të tagrave që i jepen nga statuti i shoqërisë; dhe

- **Ylliad SH.P.K.**, një shoqëri shqiptare me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar më 16/04/2009 dhe e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit më 17/04/2009, me NUIS **K91617013R**, me adresë të regjistruar në: Bulevardi "*Dëshmorët e Kombit*", Kulla Binjake Nr. 1, Kati 7, 1001 Tiranë, Shqipëri (këtu e në vijim referuar si "**Ylliad**"), e përfaqësuar rregullisht nga **Z. Julien-Gerard Emile Louis ROCHE**, shtetas shqiptar, i lindur më 07.02.1954, mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal F40702134H, në cilësinë e Administratorit të Ylliad, zotërues i 49% të kapitalit të Shoqërisë.

Nga: **Z. Julien-Gerard Emile Louis ROCHE**
Drejtor Ekzekutiv
Truen SH.P.K.
Bulevardi. *"Dëshmorët e Kombit"*, Kulla Binjake Nr. 1, Kati i 7, 1001 Tiranë, Shqipëri

Data: 01/12/2023

Në përputhje me Nenin 9.11 të Statutit të Truen ("**Statuti**"), Ortakët mund të ndërmarrin çdo veprim me fletëvotim me shkrim pa mbledhje.

Termat e përcaktuar në Marrëveshje (siç përkufizohen në vijim), përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe këtu, do të kenë të njëjtin kuptim në këtë vendim.

**MEQËNËSE:**

**A.** Kapitali i Shoqërisë, i barabartë me 44,000,000 Lekë, ndahet në 220,000 kuota, nga të cilat 112,200 kuota (që përfaqësojnë 51% të kapitalit të Shoqërisë) (këtu e në vijim referuar si ("**Kuotat CN'Air**") janë në pronësi të CN'Air SAS dhe 107,800 kuota (që përfaqësojnë 49% të kapitalit të Shoqërisë) janë në pronësi të Ylliad;

**B.** Më 01/06/2023, CN'Air dhe Ylliad inter alia kanë lidhur Protokollin e Transaksionit në kuadër të transaksionit ndërmjet CNR (COMPAGNIE NATIONALE DU RHÔNE, një shoqëri aksionare, e themeluar sipas ligjeve të Republikës së Francës, e regjistruar pranë Regjistrit të Tregtisë dhe

Shoqërive të Lyon me numër regjistrimi 957520901, me seli të regjistruar në adresën 2, rue André Bonin, 69004 Lyon, France), CN'Air, Ylliad, WEnerg, Truen dhe Z. Julien-Gerard Emile Louis ROCHE dhe në një Marrëveshje Shitje-Blerje (këtu e në vijim referuar si "**Marrëveshja**") në bazë të së cilës CN'Air do t'i shesë Ylliad të gjitha kuotat që CN'Air do të zotërojë në kapitalin e Truen në datën e hyrjes në fuqi të transferimit të kuotave sipas Marrëveshjes dhe Ylliad do t'i blejë ato kuota nga CN'Air;

**C.** Në bazë të Nenit 3 Kushtet Paraprake të Marrëveshjes, Palët duhet të përmbushin disa Kushte Pezulluese (Kushte Paraprake) përpara datës ose më 30/09/2023;

**D.** CN'Air, në cilësinë e ortakut të Truen, i ka dhënë hua Truen në vlerën 196,000 Euro. Gjithashtu, në zbatim të Nenit 3.6 të Marrëveshjes, CN'Air ka marrë përsipër t'i paguajë bankës Banka Kombëtare Tregtare SH.A. (këtu e në vijim referuar si "**BKT**"), në emër të Truen, një vlerë të barabartë me 2,100,000 Euro, vlerë e cila do të përbëjë një hua në cilësinë e tij si ortak. Për të marrë parasysh ndryshimet në kursin e këmbimit Lekë/Euro, CN'Air ka marrë përsipër të rrisë vlerën që do t'i paguhet Truen në mënyrë që Truen të shlyejë huanë e BKT-së në vlerën prej 246,729,494.19 Lekë, e cila përkon me vlerën e papaguar, duke përfshirë interesin, që i detyrohet BKT-së përpara këstit të datës 20 nëntor 2023 (sipas kontratës së huasë nr. 1 rep, nr. 1 kol, datë 04.01.2013, megjithatë me kusht që vlera që do t'i paguhet BKT-së nga CN'Air nuk duhet të kalojë vlerën prej 2,400,000 Euro. Shumat e përgjithshme që Truen do t'i detyrohet CN'Air, vlera e të cilave nuk duhet të kalojë 2,596,000 Euro, do të referohen si "**Huaja CN'Air**");

**E.** Palët dëshirojnë të ndryshojnë Marrëveshjen në mënyrë që (i) të shtyhet afati për përmbushjen e Kushteve Pezulluese më 15/12/2023, (ii) të ndryshojnë disa nene të Marrëveshjes dhe Protokollit të Transaksionit në mënyrë që të reflektojë rritjen e huasë në cilësinë e ortakut që CN'Air që do t'i paguje Truen nga në mënyrë që Truen të shlyejë huanë e BKT-së dhe (iii) dhe të bëjë ndryshime të tjera në Marrëveshjen dhe Protokollin e Transaksionit për të cilat Palët kanë rënë dakord;

**F.** Në kuadër të transaksionit të parashikuar në Marrëveshje, CN'Air synon të konvertojë Huanë CN'Air në kuota me anë të rritjes së kapitalit të Shoqërisë;

**G.** Truen ka regjistruar humbje deri në datën 31/12/2022 (referuar si "**Humbjet**"). Kapitali i Shoqërisë do të zvogëlohet për të përthithur Humbjet;

**H.** Me qëllim për të verifikuar dhe rritur kapitalin nëpërmjet konvertimit të Huasë CN'Air dhe për të zvogëluar kapitalin duke përthithur Humbjet, asambleja e përgjithshme synon të caktojë një ekspert të pavarur të certifikuar i cili do të përgatisë një raport të dhënies së sigurisë, në bazë të të cilit asambleja e përgjithshme do të mbështetet për të miratuar përkatësisht rritjen e kapitalit (duke konvertuar Huanë CN'Air në kuota) dhe zvogëlimin e kapitalit (duke përthithur Humbjet);

**I.** Në bazë të Neneve 9 dhe 10 të Statutit, Asambleja e Përgjithshme është organi vendimmarrës i Shoqërisë, i cili përbëhet nga të gjithë ortakët e Shoqërisë;

**J.** Në bazë të Neneve 9 dhe 10 të Statutit, Asambleja e Përgjithshme thirret në mënyrë të rregullt;

**K.** Ky vendim është miratuar në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe respekton plotësisht të gjitha nenet e detyrueshme të Ligjit Nr. 9901, datë 14/04/2008, "*Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare*"), i ndryshuar (këtu e në vijim referuar si "**Ligji për Shoqëritë Tregtare**").

**PRANDAJ,** anëtarët e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë kanë **VENDOSUR**:

**I.** **TË MIRATOJNË** ndryshimet në Marrëveshje;

**II.** **TË MIRATOJNË** ndryshimet në Protokollin e Transaksionit;

**III.** **TË AUTORIZOJNË** Drejtorin Ekzekutiv, në emër të Shoqërisë, për të nënshkruar ndryshimin e Marrëveshjes dhe ndryshimin e Protokollit të Transaksionit;

**IV.** **TË AUTORIZOJNË** Drejtorin Ekzekutiv të Shoqërisë, Z. Julien-Gerard Emile Louis ROCHE, të nënshkruajë dhe të dorëzojë, në emër të Shoqërisë, çdo dokument të nevojshëm në lidhje me ndryshimet dhe zbatimin e tyre dhe në përgjithësi të bëjë gjithçka që është e nevojshme për të përmbushur dhe për zbatimin e këtij vendimi.

**V.** **TË MIRATOJNË** (në parim) ndryshimet e mëposhtme në kapital:
(i)rritjen e kapitalit të Shoqërisë që do të paguhet nëpërmjet konvertimit të Huasë CN'AIR në kapital; dhe më pas
(ii)zvogëlimin e kapitalit për të përthithur Humbjet;

**VI.** **TË EMËROJNË** MAZARS SH.P.K. me NUIS K32123006W si ekspert i pavarur i ngarkuar për përgatitjen e një raporti të dhënies së sigurisë mbi vlerën e Huasë CN'Air dhe konvertimin e saj në kuota me anë të rritjes së kapitalit të Shoqërisë, si dhe për zvogëlimin e mëvonshëm të kapitalit duke përthithur Humbjet e Shoqërisë.

Ju lutemi votoni duke nënshkruar më poshtë dhe ktheni një kopje të këtij dokumenti me kopje të skanuar tek Znj. Ortenca HOXHA, ortenca.hoxha@wenerg.org, me adresë në: Bulevardin "*Dëshmorët e Kombit*", Kulla Binjake nr. 1, Kati 7, 1001 Tiranë, Shqipëri, dhe dërgoni dy origjinale të firmosura me postë rekomande.

Faleminderit për bashkëpunimin.

**Z. Julien-Gerard Emile Louis ROCHE**

....................................
Drejtori Ekzekutiv

Anëtarët e Asamblesë së Përgjithshme votuan si në vijim për vendimet e mësipërme të propozuara me Fletëvotimin me Shkrim Nr. 03/2023, datë 01/12/2023.

**HEDHJA E VOTAVE:**

Vendimet e miratuara:

.....................................................

**Ortak:** **CN'Air SAS**

Përfaqësuar nga: **Julien Rene Pierre FRANCAIS**

Vendi:................ Datë: ……………

Vendimet e refuzuara:

.....................................................

**Ortak:** **CN'Air SAS**

Përfaqësuar nga: **Julien Rene Pierre FRANCAIS**

Vendi:................ Datë: ……………

Vendimet e miratuara:

.....................................................

**Ortak:** **Ylliad SH.P.K.**

Përfaqësuar nga: **Julien-Gerard Emile Louis ROCHE**

Vendi:................ Datë: ……………

Vendimet e refuzuara:

.....................................................

**Ortak:** **Ylliad SH.P.K.**

Përfaqësuar nga: **Julien-Gerard Emile Louis ROCHE**

Vendi:................ Datë: ……………



Përktheu: Elona [illegible]

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**
**DEGA VENDORE TIRANË**
**NOTER JULIAN ZHELEGU**

V2023053950681564473

**DATE 21/12/2023**
**NR REP 11429**

PULLE TARIFE
200 LEKE
RESHQIPERISE

## VËRTETIM PËRKTHIMI

Vertetoj nënshkrimin e përkthyesit **Znj Elona Mena,** e bija e Islam, lindur më 11/02/1997, në F Kuqe, Kurbin dhe banuese në TIRANË, madhore me zotësi të plotë jurdike për të vepruar, identifikuar me Leternjoftim ID me nr. 032749553 dhe Nr. Personal J75211034C.

E cila me deklaroi se perktheu njësoj me origjinalin dokumentin bashkalidhur nga gjuha angleze ne gjuhen shqipe.

Unë, Noteri, duke gjetur këtë akt në përputhje me ligjin, e vërtetoj atë, në bazë të nenit 135 të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë".

## AUTHENTICATION OF TRANSLATION

This is to certify the authenticity of signature of translator Mrs. Elona Mena, daughter of Islam, born on F Kuqe, Kurbin, in 11/02/1997 and resident of TIRANË, adult with full legal capacity to act, identified by ID Card/ Passport No. 032749553, and Personal Number J75211034C

who stated that the above is an exact and accurate translation of the document attached from english to albanian language

I, Deputy Notary , finding this act in accordance with the law, certify it, based on Article 135 of Law no. 110, dated 20.12.2018 "For the Notary".

**NOTER**
**JULIAN ZHELEGU**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**
**DEGA VENDORE TIRANË**
**NOTER JULIAN ZHELEGU**

V20230539506818884O8

PULLE TAKSE 100 LEKE R.SHQIPERISE
PULLE TAKSE 100 LEKE R.SHQIPERISE

**DATE 21/12/2023**
**NR REP 11432**

## VËRTETIM NJËSIE ME ORIGJINALIN

Sot, më datë 21.12.2023, para meje Noterit JULIAN ZHELEGU, Anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Njesia Bashkiake nr. 5, Rr. Pjeter Bogdani, Godina Nr. 13, Hyrja Nr. 2, u paraqit personalisht:

**KËRKUES/IT**:
**Elona Mena**, atësia Islam, amësia Selvije, shtetase Shqiptare, lindur në F Kuqe, Kurbin dhe banues në TIRANË, me adresë Janaq Paço; Nd. 10; H. 2; Njësia Administrative Nr. 7; Njësia Bashkiake Nr. 7; 1023; Tiranë, lindur më 11/02/1997, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 032749553 dhe nr. personal J75211034C,

e cila me kerkoi te vertetoj dokumentin e njejte me origjinalin: Vendim i " TRUEN " Sh.p.k i dates 06.12.2023.

Unë Noteri, pasi i bëra të qartë personit të mësipërm, përgjegjësinë penale në rast paraqitje të dokumenti të rremë; bëra krahasimin e përmbajtjes së dokumentit origjinal me fotokopjen e paraqitur, mbi të cilat më rezulton se nuk janë bërë korrigjime, shtesa, fshirje, a shenja të tjera të dyshimta.

Si rrjedhim, në bazë të nenit 62, shkronja "i", nenit 129 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë"; Vërtetoj se fotokopja e dokumentit të paraqitur nga kërkuesi para meje Noterit, është e njëjtë me dokumentin origjinal.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të kërkuesit të këtij dokumenti, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**NOTER**

JULIAN ZHELEGU

**RESOLUTION BY WRITE-IN-BALLOT**
**OF THE GENERAL MEETING OF THE SHAREHOLDERS OF**
**THE LIMITED LIABILITIES COMPANY**
**TRUEN SH.P.K.**

**Truen Sh.p.k.**, is an Albanian Limited Liability Company, established and duly exercising its activity under the Albanian laws, registered with the Albanian National Business Centre with its registration number (NUIS) **L21617015E** and with its registered address at: Blvd. *"Dëshmorët e Kombit"*, Twin Tower No. 1, 7th Floor, 1001 Tirana, Albania (hereinafter referred as "**Truen**" or the "**Company**"). The Executive Director of the Company is **Mr. Julien-Gerard Emile Louis ROCHE** (hereinafter referred to as the "**Executive Director**").

**Date:** 06/12/2023
**Resolution No.:** 04/2023

**AGENDA:**

1. Approval of the increase of share capital of the Company to be paid up through conversion of the CN'Air Loan (as defined below) and of the subsequent decrease of the share capital of the Company by absorbing the Losses (as defined below);

2. Amendment of the Articles of Association of the Company;

3. Miscellaneous.

**NOTICE** to the members of the General Meeting of the Company, constituted as follows:

- **CN'Air SAS**, a simplified joint stock company, incorporated under the laws of France, registered at the Commercial Tribunal of Lyon with its registration No. 450809835 RCS Lyon, on 14/11/2003, with its registered seat at: 2, Rue André Bonin 69004 Lyon, France (hereinafter referred as "**CN'Air**"), owner of 51% of the share capital of the Company, duly represented by its President, the company Compagnie Nationale du Rhône, herein represented by its General Director **Mr. Julien Rene Pierre FRANCAIS**, citizen of France, born on 03/04/1978 in Saint-Die-des-Vosges (88), France, holder of the ID Card No. 200269158936, acting pursuant to the powers granted to him under the bylaws of the company; and

- **Ylliad Sh.p.k.**, an Albanian Limited Liability Company, established on 16/04/2009 and registered with the Albanian National Business Center on 17/04/2009, with NUIS **K91617013R**, with its registered address at: Blvd. *"Dëshmorët e Kombit"*, Twin Tower No. 1, 7th Floor, 1001 Tirana, Albania (hereinafter referred as "**Ylliad**"), duly represented by **Mr. Julien-Gerard Emile Louis ROCHE**, Albanian citizen, born on 02/07/1954, holder of the ID with Personal No. F40702134H, in his capacity of the Administrator of Ylliad, owner of 49% of the share capital of the Company.

From: **Mr. Julien-Gerard Emile Louis ROCHE**
Executive Director
Truen Sh.p.k.
Blvd. *"Dëshmorët e Kombit"*, Twin Tower No. 1, 7th Floor, 1001 Tirana, Albania

Date: 06/12/2023

In accordance with Article 9.11 of the Articles of Association of Truen ("**AoA**"), the Shareholders may take any action by write-in-ballot without a meeting.

Terms defined in the SPA (as defined below) shall, unless otherwise defined herein, have the same meaning in this resolution.

**WHEREAS:**

**A.** The capital of the Company, equal to 44,000,000 Albanian Lek, is divided into 220,000 shares, of which 112,200 shares (representing 51% of the Company's share capital) (hereinafter referred to as the "**CN'Air Shares**") are owned by CN'Air and 107,800 shares (representing 49% of the Company's share capital) are owned by Ylliad;

**B.** On 01/06/2023, CN'Air and Ylliad have entered into a Sale and Purchase Agreement pursuant to which CN'Air will sell the CN'Air Shares to Ylliad and Ylliad will purchase CN'Air Shares (hereinafter referred to as the "**SPA**");

**C.** The parties of the SPA have amended the SPA on 02/12/2023, postponing the deadline for fulfilment of Suspensive Conditions on 15/12/2023;

**D.** On 01/06/2023, CN'Air and Ylliad inter alia have entered into the settlement agreement (the "**Transaction Protocol**") in the framework of the transaction between CNR, CN'Air, Ylliad, WEnerg, Truen and Mr Julien-Gerard Emile Louis ROCHE;

**E.** The parties of the Transaction Protocol have amended the Transaction Protocol on 02/12/2023, allowing the advance paid by CN'Air to repay the BKT loan to be increased in line with changes in the exchange rate, subject to a certain limit and other changes the parties agreed upon;

**F.** CN'Air has granted shareholders loan to Truen amounting to 196,000 Euro. In addition, pursuant to Article 3.6 of the SPA, as amended, CN'Air has paid to Truen an amount equal to 2,400,000 Euro, which amount constitutes a shareholder loan, and which amount was used by Truen to repay to Banka Kombëtare Tregtare SH.A. ("**BKT**"), the loan of 246,729,494.19 Albanian Leke (under the loan contract no. 1 rep, no. 1 col, dated 04.01.2013 between Truen and BKT). The overall amount owed to CN'Air by Truen of 2,596,000 Euro shall be referred to as the "**CN'Air Loan**";

G. In the framework of the transaction envisaged under the SPA, CN'Air intends to convert the CN'Air Loan into shares by way of an increase of the share capital of the Company;

H. Truen has recorded losses until the date 31/12/2022 (referred to as the "**Losses**"). The Company's share capital will be reduced to partially absorb the Losses, up to the amount corresponding to the antecedent capital increase. The rest of the Losses shall be carried forward;

I. In order to increase the share capital by conversion of the CN'Air Loan and decrease the share capital by absorbing the Losses, the general meeting has appointed MAZARS Sh.p.k. with identification no. K32123006W as certified independent auditor which has prepared an assurance report, based on which the general meeting shall approve respectively the increase of the share capital (through conversion of the CN'Air Loan) and decrease of the share capital (by partially absorbing the Losses);

J. The new share capital of the Company will amount to 44,000,000 Albanian Lek (forty-four million), divided into 2 (two) shares, of which 1 share (representing 93.08% of the Company's share capital) is owned by CN'Air, and 1 share (representing 6.92% of the Company's share capital) is owned by Ylliad;

K. Following the changes to the share capital of the Company, the members of the General Meeting of the Company intend to amend Article 5 Share Capital of the Company's Articles of Association (form attached) as follows:

*Article 5 – Capital*

*The capital subscribed and fully paid of the Company is 44,000,000 (forty-four million) Albanian Lek, divided into 2 (two) shares. The capital is subscribed and fully paid by the shareholders as follows:*

*CN'Air SAS – owner of 1 (one) share, with a nominal value of 40,957,128 ((forty million nine hundred fifty-seven thousand one hundred twenty-eight) Albanian Leke, representing 93.08% of the Company's capital;*

*Ylliad Sh.p.k. – owner of 1 (one) share, with a nominal value of 3,042,872 (three million forty-two thousand eight hundred seventy-two) Albanian Leke, representing 6.92% of the Company's capital;*

L. Pursuant to the Articles 9 and 10 of the AoA, the General Meeting is the decision-making body of the Company, which consists of all the shareholders of the Company;

M. Pursuant to the Articles 9 and 10 of the AoA, the General Meeting is duly convened;

N. This resolution is adopted in accordance with the Articles of Association of the Company and fully respects all the mandatory dispositions of the Law No. 9901, dated 14/04/2008 "*On Entrepreneurs and Commercial Companies*", as amended (hereinafter referred to as the "**Company Law**").

THEREFORE, the members of the General Meeting of the Company have **RESOLVED**:

I. **TO APPROVE** the changes to the share capital:
**(i)** Increase the share capital of the Company to be paid up through conversation of the CN'AIR Loan into share capital; and subsequently
**(ii)** to reduce the share capital to absorb the Losses up to 267,758,063 ALL (the amount corresponding to the antecedent capital increase).
The rest of the Losses shall be carried forward.

II. **TO APPROVE** the new share capital of the Company as follows:

The new share capital of the Company will amount to 44,000,000 Albanian Lek (forty-four million), divided into 2 (two) shares, of which 1 share (representing 93.08% of the Company's share capital) is owned by CN'Air, and 1 share (representing 6.92% of the Company's share capital) is owned by Ylliad.

III. **TO APPROVE** the amendment to the Articles of Association of the Company, as follows:

*Article 5 – Capital*

*The capital subscribed and fully paid of the Company is 44,000,000 (forty-four million) Albanian Lek, divided into 2 (two) shares. The capital is subscribed and fully paid by the shareholders as follows:*

*CN'Air SAS – owner of 1 (one) share, with a nominal value of 40,957,128 ((forty million nine hundred fifty-seven thousand one hundred twenty-eight) Albanian Leke, representing 93.08% of the Company's capital;*

*Ylliad Sh.p.k. – owner of 1 (one) share, with a nominal value of 3,042,872 (three million forty-two thousand eight hundred seventy-two) Albanian Leke, representing 6.92% of the Company's capital;*

IV. **TO AUTHORIZE** the Executive Director of the Company, Mr. Julien-Gerard Emile Louis ROCHE, to sign and deliver, on behalf of the Company, any necessary document regarding the to fulfil and make this resolution effective.

Please cast your vote by signing below and return a copy of this document by scanned copy to Mrs. Ortenca HOXHA, ortenca.hoxha@wenerg.org, with address at: Blvd. *"Dëshmorët e Kombit"*, Twin Tower no. 1, 7th Floor, 1001 Tirana, Albania, and transmit two signed originals by registered mail.

Thank you for your cooperation.

**Mr. Julien-Gerard Emile Louis ROCHE**

.............................................

Executive Director

The members of the General Meeting casted the following vote on the above resolutions proposed by Write-in Ballot No. 04/2023, of date 06/12/2023.

**CAST OF VOTE:**

Resolutions approved: ..........................................

**Shareholder:** **CN'Air SAS**
Represented by: **Julien Rene Pierre FRANCAIS**

Place: ..Lyon. Date: .06/12/23

Resolutions rejected: ..........................................

**Shareholder:** **CN'Air SAS**
Represented by: **Julien Rene Pierre FRANCAIS**

Place: .................. Date: ...............

Resolutions approved: ..........................................

**Shareholder:** **Ylliad Sh.p.k.**
Represented by: Julien-Gerard Emile Louis ROCHE

Place: Tirana Date: ..6/12/23

Resolutions rejected: ..........................................

**Shareholder:** **Ylliad Sh.p.k.**
Represented by: Julien-Gerard Emile Louis ROCHE

Place: .................. Date: ...............

**VENDIM ME FLETËVOTIM ME SHKRIM**
**I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË**
**SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**
**TRUEN SH.P.K.**

**Truen SH.P.K.**, është një shoqëri shqiptare me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe që ushtron rregullisht aktivitetin sipas ligjeve të Shqipërisë, regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me numër regjistrimi (NUIS) **L21617015E** dhe me adresë të regjistruar : Bulevardi *"Dëshmorët e Kombit"*, Kulla Binjake Nr. 1, Kati i 7, 1001 Tiranë, Shqipëri (këtu e në vijim referuar si "**Truen**" ose "**Shoqëria**"). Drejtori Ekzekutiv i Shoqërisë është **Z. Julien-Gerard Emile Louis ROCHE** (këtu e në vijim referuar si "**Drejtori Ekzekutiv**").

**Data**: 06/12/2023
**Vendimi Nr.**: 04/2023

**RENDI I DITËS:**

1. Miratimi i rritjes së kapitalit të Shoqërisë që do të paguhet nëpërmjet konvertimit të Huasë CN'Air (siç përkufizohet më poshtë) dhe i zvogëlimit të mëvonshëm të kapitalit të Shoqërisë duke përthithur Humbjet (siç përkufizohet më poshtë);

2. Ndryshimi i Statutit të Shoqërisë;

3. Të ndryshme.

**NJOFTIM** për anëtarët e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë, e përbërë si në vijim:

- **CN'Air SAS**, një shoqëri e thjeshtë aksionare, e themeluar sipas ligjeve të Francës, e regjistruar pranë Regjistrit Tregtar të Lyon me numër regjistrimi 450809835 RCS Lyon, më 14/11/2003, me selinë e regjistruar në: 2, Rue André Bonin 69004 Lyon, Francë (këtu e në vijim referuer si "**CN'Air**"), zotërues i 51% të kapitalit të Shoqërisë, e përfaqësuar rregullisht nga Presidenti i saj, shoqëria Compagnie Nationale du Rhône, e përfaqësuar këtu nga Drejtori i Përgjithshëm i saj **Z. Julien Rene Pierre FRANCAIS**, shtetas francez, i lindur më 04.03.1978 në Saint-Die-des-Vosges (88), Francë, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 200269158936, duke vepruar në zbatim të tagrave që i jepen nga statuti i shoqërisë; dhe

- **Ylliad SH.P.K.**, një shoqëri shqiptare me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar më 16/04/2009 dhe e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit më 17/04/2009, me NUIS **K91617013R**, me adresë të regjistruar në: Bulevardi "*Dëshmorët e Kombit*", Kulla Binjake Nr. 1, Kati 7, 1001 Tiranë, Shqipëri (këtu e në vijim referuar si "**Ylliad**"), e përfaqësuar rregullisht nga **Z. Julien-Gerard**

**Emile Louis ROCHE**, shtetas shqiptar, i lindur më 07.02.1954, mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal F40702134H, në cilësinë e Administratorit të Ylliad, zotërues i 49% të kapitalit të Shoqërisë.

Nga: **Z. Julien-Gerard Emile Louis ROCHE**
Drejtor Ekzekutiv
Truen Sh.p.k.
Bulevardi. *"Dëshmorët e Kombit"*, Kulla Binjake Nr. 1, Kati i 7, 1001 Tiranë, Shqipëri

Data: 06/12/2023

Në përputhje me Nenin 9.11 të Statutit të Truen ("**Statuti**"), Ortakët mund të ndërmarrin çdo veprim me fletëvotim me shkrim pa mbledhje.

Termat e përcaktuar në Marrëveshje (siç përkufizohet më poshtë), përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe këtu, do të kenë të njëjtin kuptim në këtë vendim.

**MEQËNËSE:**

**A.** Kapitali i Shoqërisë, i barabartë me 44,000,000 Lekë, ndahet në 220,000 kuota, nga të cilat 112,200 kuota, (që përfaqësojnë 51% të kapitalit të Shoqërisë) (këtu e në vijim referuar si ("**Kuotat CN'Air**") janë në pronësi të CN'Air SAS dhe 107,800 kuota (që përfaqësojnë 49% të kapitalit të Shoqërisë) janë në pronësi të Ylliad;

**B.** Më 01/06/2023, CN'Air dhe Ylliad kanë lidhur një Marrëveshje Shitblerje në bazë të së cilës CN'Air do t'i shesë Kuotat CN'Air Ylliad-it dhe Ylliad do të blejë Kuotat CN'Air (këtu e në vijim referuar si "**Marrëveshja**");

**C.** Palët e Marrëveshjes kanë ndryshuar Marrëveshjen më 02/12/2023, duke shtyrë afatin për përmbushjen e Kushteve Pezulluese (Kushteve Paraprake) më 15.12.2023;

**D.** Më 01/06/2023, CN'Air dhe Ylliad inter alia kanë lidhur një marrëveshje zgjidhjeje së mosmarrëveshjes ("**Protokolli i Trasaksionit**") në kuadër të transaksionit ndërmjet CNR, CN'Air, Ylliad, WEnerg, Truen dhe Z. Julien-Gerard Emile Louis ROCHE;

**E.** Palët e Protokollit të Trasaksionit kanë ndryshuar Protokollin e Trasaksionit më 02/12/2023, duke lejuar rritjen e pagesës së parakohshme nga CN'Air për shlyerjen e huasë së BKT-së në përputhje me ndryshimet në kursin e këmbimit, me një kufi të caktuar dhe ndryshime të tjera për të cilat palët kanë rënë dakord;

**F.** CN'Air, në cilësinë e ortakut të Truen, i ka dhënë hua Truen në vlerën prej 196,000 Euro. Përveç kësaj, në bazë të Nenit 3.6 të Marrëveshjes, së ndryshuar, CN'Air i ka paguar Truen një vlerë të barabartë me 2,400,000 Euro, vlerë e cila përbën një hua nga CN'Air, në cilësinë e ortakut të Truen, të cilën Truen e ka përdorur për të shlyer huanë e Bankës Kombëtare Tregtare SH.A. ("**BKT**"), hua me vlerë prej 246,729,494,19 Lekë (sipas kontratës së kredisë nr. 1 rep, nr. 1 kol, datë 04.01.2013 ndërmjet Truen dhe BKT). Vlera e përgjithshme që CN'Air i detyrohet Truen prej 2,596,000 Euro do të referohet si "**Huaja CN'Air**";

**G.** Në kuadër të transaksionit të parashikuar në Marrëveshje, CN'Air synon të konvertojë Huanë CN'Air në kuota me anë të rritjes së kapitalit të Shoqërisë;

**H.** Truen ka regjistruar humbje deri në datën 31/12/2022 (të referuara si "**Humbjet**"). Kapitali i Shoqërisë do të zvogëlohet për të përthithur pjesërisht Humbjet, deri në vlerën që korrespondon me rritjen e mëparshme të kapitalit. Pjesa tjetër e Humbjeve do të bartet në vijim;

**I.** Në mënqyrë që të rritet kapitali me konvertim të Huasë CN'Air dhe zvogëlimin e kapitalit duke përthithur Humbjet, asambleja e përgjithshme ka caktuar MAZARS Sh.p.k. me NUIS K32123006W si ekspert i pavarur i certifikuar i cili ka përgatitur një raport të dhënies së sigurisë, në bazë të të cilit asambleja e përgjithshme do të miratojë përkatësisht rritjen e kapitalit (nëpërmjet konvertimit të Huasë CN'Air) dhe zvogëlimin e kapitalit (duke përthithur pjesërisht Humbjet);

**J.** Kapitali i ri i Shoqërisë do të jetë 44,000,000 Lekë (dyzet e katër milionë), i ndarë në 2 (dy) kuota, nga të cilat 1 kuotë (që përfaqëson 93.08% të kapitalit të Shoqërisë) zotërohet nga CN'Air, dhe 1 kuotë (që përfaqëson 6.92% të kapitalit të Shoqërisë) zotërohet nga Ylliad;

**K.** Pas ndryshimeve në kapitalin e Shoqërisë, anëtarët e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë synojnë të ndryshojnë Nenin 5 Kapitali të Statutit të Shoqërisë (forma bashkëlidhur) si në vijim:

*Neni 5 – Kapitali*

*Kapitali i nënshkruar dhe i paguar plotësisht i Shoqërisë është 44,000,000 (dyzet e katër milionë) lekë shqiptare, i ndarë në 2 (dy) kuota. Kapitali nënshkruhet dhe paguhet plotësisht nga ortakët si më poshtë:*

*CN'Air SAS – zotërues i 1 (një) kuote, me vlerë nominale prej 40,957,128 (dyzet milionë e nëntëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e njëzet e tetë) Lekë, që përfaqëson 93,08% të kapitalit të Shoqërisë;*

*Ylliad Sh.p.k. – zotërues i 1 (një) kuote, me vlerë nominale 3,042,872 (tre milionë e dyzet e dy mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e dy) Lekë, që përfaqëson 6,92% të kapitalit të Shoqërisë;*

**L.** Në bazë të Neneve 9 dhe 10 të Statutit, Asambleja e Përgjithshme është organi vendimmarrës i Shoqërisë, i cili përbëhet nga të gjithë ortakët e Shoqërisë;

**M.** Në bazë të Neneve 9 dhe 10 të Statutit të Shoqërisë, Asambleja e Përgjithshme është thirurr rregullisht;

**N.** Ky vendim është në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe respekton plotësisht të gjitha dispozitat e detyrueshme të Ligjit Nr. 9901, datë 14/04/2008 ("*Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare*"), i ndryshuar (këtu e në vijim referuar si "**Ligji për Shoqëritë Tregtare**").

**Prandaj,** anëtarët e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë kanë **VENDOSUR**:

**I.** **TË MIRATOJNË** ndryshimet në kapital:
**(i)** Rritja e kapitalit të Shoqërisë që do të paguhet përmes konvertimit të Huasë CN'AIR në kapital; dhe më pas
**(ii)** zvogëlimi i kapitalit për të përthithur Humbjet deri në 267,758,063 Lekë (vlerë që korrespondon me rritjen paraardhëse të kapitalit).
Pjesa tjetër e Humbjeve do të bartet në vijim.

**II.** **TË MIRATOJNË** kapitalin e ri të Shoqërisë si më poshtë:
Kapitali i ri i Shoqërisë do të jetë 44,000,000 Lekë (dyzet e katër milionë), i ndarë në 2 (dy) kuota, nga të cilat 1 kuotë (që përfaqëson 93.08% të kapitalit të Shoqërisë) zotërohet nga CN'Air, dhe 1 kuotë (që përfaqëson 6.92% të kapitalit të Shoqërisë) zotërohet nga Ylliad.

**III.** **TË MIRATOJNË** ndryshimin e Statutit të Shoqërisë si më poshtë:

*Neni 5 – Kapitali*

*Kapitali i nënshkruar dhe i paguar plotësisht i Shoqërisë është 44,000,000 (dyzet e katër milionë) Lekë, i ndarë në 2 (dy) kuota. Kapitali nënshkruhet dhe paguhet plotësisht nga ortakët si më poshtë:*

*CN'Air SAS – zotërues i 1 (një) kuote, me vlerë nominale 40,957,128 (dyzet milionë e nëntëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e njëzet e tetë) Lekë, që përfaqëson 93,08% të kapitalit të Shoqërisë;*

*Ylliad Sh.p.k. – pronar i 1 (një) kuote, me vlerë nominale 3,042,872 (tre milionë e dyzet e dy mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e dy) Lekë, që përfaqëson 6,92% të kapitalit të Shoqërisë;*

**IV.** **TË AUTORIZOJNË** Drejtorin Ekzekutiv të Shoqërisë, Z. Julien-Gerard Emile Louis ROCHE, të nënshkruajë dhe dorëzojë, në emër të Shoqërisë, çdo dokument të nevojshëm në lidhje me përmbushjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ju lutem votoni duke nënshkruar më poshtë dhe kthejeni një kopje të këtij dokumenti me kopje të skanuar te Znj. Ortenca HOXHA, ortenca.hoxha@wenerg.org, me adresë: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Kulla Binjake nr. 1, Kati 7, 1001 Tiranë, Shqipëri, dhe dërgoni dy origjinale të firmosura me postë rekomande.

Faleminderit për bashkëpunimin.

Z. Julien-Gerard Emile Louis ROCHE

.....................................
Drejtor Ekzekutiv

Anëtarët e Asamblesë së Përgjithshme hodhën votat e mëposhtme për vendimet e mësipërme të propozuara në fletëvotimin me shkrim Nr. 04/2023, datë 06/12/2023.

**VOTAT E MARRA:**

Vendimet e miratuara: ......................................................

**Ortak:** **CN'Air SAS**
Përfaqësuar nga: **Julien Rene Pierre FRANCAIS**
Vendi: .................... Data: ................

Vendimet e refuzuara: ......................................................

**Ortak:** **CN'Air SAS**
Përfaqësuar nga: **Julien Rene Pierre FRANCAIS**
Vendi: .................... Data: ................

Vendimet e miratuara: ......................................................

**Ortak:** **Ylliad Sh.p.k.**
Përfaqësuar nga: Julien-Gerard Emile Louis ROCHE
Vendi: .................... Data: ................

Vendimet e refuzuara: ......................................................

**Ortak:** **Ylliad Sh.p.k.**
Përfaqësuar nga: Julien-Gerard Emile Louis ROCHE
Vendi: .................... Data: ................

Përktheu: Elona Hasani.

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**
**DEGA VENDORE TIRANË**
**NOTER JULIAN ZHELEGU**

V20230539506819S7914

PULLE TAKSE 100 LEKE R. SHQIPERISE
PULLE TAKSE 100 LEKE R. SHQIPERISE

**DATE 21/12/2023**
**NR REP 11433**

## VËRTETIM PËRKTHIMI

Vertetoj nënshkrimin e përkthyesit **Znj Elona Mena,** e bija e Islam, lindur më 11/02/1997, në F Kuqe, Kurbin dhe banuese në TIRANË, madhore me zotësi të plotë jurdike për të vepruar, identifikuar me Leternjoftim ID me nr. 032749553 dhe Nr. Personal J75211034C.

E cila me deklaroi se perktheu njësoj me origjinalin dokumentin bashkalidhur nga gjuha angleze ne gjuhen shqipe.

Unë, Noteri, duke gjetur këtë akt në përputhje me ligjin, e vërtetoj atë, në bazë të nenit 135 të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë".

## AUTHENTICATION OF TRANSLATION

This is to certify the authenticity of signature of translator Mrs. Elona Mena, daughter of Islam, born on F Kuqe, Kurbin, in 11/02/1997 and resident of TIRANË, adult with full legal capacity to act, identified by ID Card/ Passport No. 032749553, and Personal Number J75211034C

who stated that the above is an exact and accurate translation of the document attached from english to albanian language

I, Deputy Notary , finding this act in accordance with the law, certify it, based on Article 135 of Law no. 110, dated 20.12.2018 "For the Notary".

**NOTER**
**JULIAN ZHELEGU**